



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2454 .Prot.

Rrogozhinë, më 15.06.2026

NJOFTIM

Në mbështetje të pikës 4, nenit 53 të Ligjit Nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Bashkiak Rrogozhinë”, njoftoj thirrjen e mbledhjes së radhës të Këshillit Bashkiak e cila **do të zhvillohet në sallën e mbledhjeve të Këshillit, ditën Enjte datë 18.06.2026 ora 14:00^{oo}**, me rendin e ditës si më poshtë :

- 1- Miratim i rendit të ditës.
- 2- Miratim i procesverbalit Nr.7, të mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 11.06.2026.
- 3- Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Maj 2026 nga fondi i Bllok - Ndihmës 6%”.
- 4- Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Qershor 2026 nga fondi i pushtetit vendor”.
- 5- Miratim i projekt - vendimit, “Për miratimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve për programin buxhetor afatmesëm të bashkisë Rrogozhinë për vitet 2027-2029.
- 6- Miratim i projekt- vendimit, “Për përdorimin e fondit të emergjencave civile”.
- 7- Miratim i projekt - vendimit, “Për miratimin e Plan Masash ‘Për parandalimin dhe menaxhimin e zjarreve masat që duhet të merren për mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave bashkiake nga zjarret’ “.
- 8- Miratim i projekt- vendimit, “Për miratimin e programit të transparencës së Bashkisë Rrogozhinë”.
- 9- Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e opinionit mbi propozimin për planin e ri tarifor për ujësjellësin Rrogozhinë sipas shkresës së Këshillit Mbikqyrës të Shoqërisë Rajonale UK Durrës SH.A me Nr.3235.Prot datë 08.06.2026”.
- 10- Miratim i projekt - vendimit, “Për shtimin e punonjësve sezonal plazhi (me kontratë) për periudhën Korrik-Shtator 2026”.
- 11- Shqyrtim i kërkesës për informacion dhe ndërhyrje institucionale të anëtarit të këshillit bashkiak z. Mitat Daja.
- 12- Të njihemi me shkresën “Kthim përgjigje” drejtuar këshilltarit z. Mitat Daja në cilësinë e kryetarit të komisionit të përkohshëm për verifikimin e procesit të rindërtimit.
- 13- Raport mbi punën e bërë nga drejtoria juridike pranë bashkisë Rrogozhinë.
- 14- Raport nga administratorët e Njësive mbi punën e bërë përgjatë periudhës Janar-Maj 2026.
- 15- Të ndryshme.

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruja e Kavajës, Blloku “12 Shtatori” Email:brrogozhine@gmail.com



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK

Mbledhjet e Komisioneve të KB, si më poshtë :

- Njoftoj të mbledhet ditën e Mërkurë datë 17.06.2026 ora 13 : 00^{oo}, Komisioni i Financës, Taksave dhe Revizionimit, me këtë përbërje : Alime Hoxha - Kryetare, Merilin Saraçi - Zëvendëskryetare, Enver Memolla - Anëtar, Gëzime Met-hasani - Anëtare, Indrit Dedej - Anëtar.
- Njoftoj të mbledhet ditën e Mërkurë datë 17.06.2026 ora 13 : 30^{oo}, Komisioni Juridike, Rend, Konfliktë, me këtë përbërje : Enver Memolla - Kryetar, Indrit Dedej - Zv. Kryetar, Mitat Daja - Anëtar , Renato Kalemi - Anëtar, Merilin Saraçi-Anëtare.

Shënim :

- Pikat 5, 6, 7, 8 dhe 11 shqyrtohet i njëjti material i vënë në dispozicion në mbledhjet paraardhëse të KB.
- Cilido komision tjetër që e konsideron të arsyeshme për t'u mbledhur dhe për të shqyrtuar një apo disa pika të rendit të ditës është i lutur të kordinojë me Sekretarin e Këshillit Bashkiak.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

KRYETARE E KËSHILLIT
MUKADES GIXHARI



Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com